

VENDIM
Nr.50, datë 24.8.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
LEHTËSIMIN E HYRJES NË RRJET TË CENTRALEVE ELEKTRIKE, ME KAPACITET
TË PËRGJITHSHËM, JO MË TË MADH SE 5 MW**

Në mbështetje të nenit 9 pika 3 dhe 42 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike ERE, në mbledhjen e tij të datës 24.8.2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e rregullores për lehtësimin e hyrjes në rrjet të centraleve elektrike, me kapacitet të përgjithshëm, jo më të madh se 5 MW.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-S
Bujar Nepravishta